



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	21.07.2021
Referenc-ë:	07-353/04-14619/21
Për/ Za/ To:	Komiteti Olimpik i Kosovës
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-14619/21 nga Komiteti Olimpik i Kosovës me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi “Skënderbeu” afër teatrit Kombëtar me datë 23 Korrik 2021 deri më 8 Gusht 2021 nga ora 09:00 – 12:00 si dhe nga ora 18:00 – 21:00.

Në shesh do të vendosen rekuizita rekuizita të sporteve të ndryshme verore dhe do të promovohen këto sporte: xhudo, boks, not, shenjëtari sportive e mundje.

Gjithashtu do të vendoset një ekran i madh nëpërmjet të cilit qytetarët do të kenë mundësi do të përcjellin ceremoninë solemne të hapjes së lojërave olimpike verore , garat e sportistëve të Kosovës si dhe ceremoninë e mbylljes së lojërave olimpike.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Komitetit Olimpik i Kosovës për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” afër teatrit Kombëtar nga data 23 Korrik 2021 deri më 8 Gusht 2021 nga ora 09:00- 12:00 si dhe nga ora 18:00 – 21:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Aktiviteti të jetë në koordinim me policinë e Kosovës. Nëse nuk konfirmohet koordinimi i lartcekur ky pëlqim nuk vlen;
- Organizatori merr përsipër shpenzimet e energjisë elektrike për këtë aktivitet;
- Pas përfundimit të aktivitetit të pastrohet sheshi dhe të kthehet në gjendjen e më parshme;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.